

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR MBROJTJEN CIVILE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji ka si qëllim zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe realizimin e mbrojtjes civile për të garantuar mbrojtjen e jetës së njerëzve, të pronës, të gjësë së gjallë, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit, nëpërmjet forcimit të sistemit të mbrojtjes civile.

Sipas këtij projektligji, mbrojtja civile ka si mision krijimin e kushteve për një shoqëri të aftë për të përballuar fatkeqësitë e ndryshme dhe për t’u rimëkëmbur, nëpërmjet ngritjes së një sistemi të integruar dhe efikas të mbrojtjes civile në Republikën e Shqipërisë.

Projektligji rregullon funksionimin e sistemit të mbrojtjes civile, duke përcaktuar qartë përgjegjësitë e institucioneve dhe të strukturave të këtij sistemi, bashkëpunimin ndërkombëtar, të drejtat dhe detyrimet e shtetasve dhe të subjekteve private, edukimin, trajnimin dhe inspektimin.

Ky projektligj do të sigurojë përshtatjen e sistemit të mbrojtjes civile me standardet evropiane, në përputhje edhe me prioritetet e kuadrit “Sendai” për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë.

Objektivat e këtij projektligji janë, si më poshtë vijon:

- a) Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë, nëpërmjet identifikimit të saktë, vlerësimit periodik të riskut dhe monitorimit të tij, duke zbutur pasojat negative të fatkeqësive, duke investuar në parandalimin e risqeve, duke intensifikuar bashkëpunimin e të gjitha subjekteve të këtij ligji, si dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet tyre, nëpërmjet parashikimit të masave, në funksion të realizimit të tij.
- b) Forcimi i sistemit të mbrojtjes civile, nëpërmjet krijimit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC), si person juridik, publik, qendror në varësi të ministrit përgjegjës për mbrojtjen civile, që përgjigjet për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. AKMC-ja do të jetë autoriteti më i lartë koordinues, bashkërendues, drejtues, teknik, mbikëqyrës dhe kontrollues në fushën e zvogëlimin të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile. AKMC-ja do të organizohet si drejtori e përgjithshme në nivel qendror, ndërsa në nivel vendor organizohet në bazë qarku, sipas qendrave të mbrojtjes civile.

- c) Forcimi i kapaciteteve administrative, teknike dhe financiare të sistemit të mbrojtjes civile në tërësinë e tij, nëpërmjet përcaktimit më qartë të rolit dhe përgjegjësi të të gjithë aktorëve të këtij sistemi, në nivel qendror, në nivel qarku dhe në nivel vendor.
- ç) Integrimi i prioritetëve, i qëllimeve dhe i objektivave të kuadrit “Sendai” për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive, në politikat e qeverisjes në të gjitha nivelet, veçanërisht nëpërmjet hartimit dhe implementimit të Strategjisë Kombëtare dhe strategjive vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, vlerësimeve të riskut nga fatkeqësitë dhe planeve të emergjencave civile në nivel qendror, në nivel qarku dhe në nivel vendor, si dhe masave të tjera.
- d) Përmirësimi i edukimit për mbrojtjen civile në shkolla, nëpërmjet përfshirjes së lëndëve përkatëse arsimore në nivelin arsimor parauniversitar.
- dh) Mirëfunksionimi i sistemit të paralajmërimit të hershëm, i monitorimit, njoftimit dhe alarmit, duke përcaktuar detyrat për institucionet përgjegjëse dhe subjektet private, të përfshirë në të.
- e) Parashikimi i rregullave më të qarta të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe atij ndërinstitutional në kuadër të asistencës ndërkombëtare dhe të procedurave përkatëse.
- ë) Rritja e rolit ndërkombëtar të Republikës së Shqipërisë në fushën e zvogëlimin të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, nëpërmjet rolit më të madh dhe më aktiv të saj dhe përmbushjes së kontributeve në BE, NATO, OKB, OSBE etj.
- f) Bërja e çështjes së zvogëlimin të riskut nga fatkeqësitë në një çështje të secilit sikurse të të gjithë shoqërisë. Kjo do të arrihet, ndër të tjera, nëpërmjet rritjes së rolit të të gjithë aktorëve shtetërorë, individëve dhe subjekteve private në zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile dhe nëpërmjet përcaktimit të të drejtave e detyrave që ato kanë në këtë fushë.
- g) Planifikimi dhe realizimi sa më cilësor i masave strukturore dhe jostrukturore në fushën e zvogëlimin të riskut të fatkeqësive dhe mbrojtjes civile, me theks të veçantë te masat parandaluese nga fatkeqësitë dhe atyre rehabilituese në infrastrukturë.
- gj) Zbatimi më i mirë i detyrave dhe i përgjegjësi të të gjithë aktorëve të sistemit të mbrojtjes civile, nëpërmjet sanksionimit të kundërvajtjeve administrative, zbatimi i të cilave do të kontrollohet nëpërmjet inspektimit që do të kryhet nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është në përputhje me objektivat e Këshillit të Ministrave dhe të Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe është planifikuar në programin e përgjithshëm analitik të projekteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, për vitin 2019.

Hartimi i këtij projektligji synon ngritjen në një nivel më të lartë të efektivitetit të sistemit të mbrojtjes civile, për mbrojtjen e jetës së njerëzve, të pronës, të trashëgimisë kulturore dhe mjedisit, si dhe implementimin për herë të parë të masave shumësektoriale në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ligji aktual nr.8756, datë 26.3.2001, “Për emergjencat civile”, i ndryshuar, ka hedhur baza kryesisht në fushën e planifikimit dhe të përballimit të emergjencave civile, por ai nuk ka asnjë përcaktim për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, sikurse ka mangësi thelbësore në shumë përcaktime të tij për fusha, siç janë: paralajmërimi i hershëm, edukimi, trajnimi, asistenca ndërkombëtare, monitorimi, njoftimi, alarmi dhe inspektimi.

Me projektligjin e ri synohet vendosja e koncepteve moderne, gjithëpërfshirëse dhe në përputhje me terminologjinë evropiane e botërore, duke synuar zbatimin më efektiv të masave për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, të cilat nga ana e tyre do të kishin një ndikim thelbësor në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Përgatitja e projektligjit “Për mbrojtjen civile” është bërë në zbatim të urdhrit të Kryeministrit nr.78, datë 24.5.2018.

Me qëllim marrjen edhe të një shembulli të një ligji të ngjashëm të një vendi anëtar të BE-së, por edhe me karakteristika të ngjashme me Shqipërinë, është shfrytëzuar ligji slloven “Mbi mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera”, ligje të tjera si ai i Kosovës “Për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera” dhe i Malit të Zi “Mbi mbrojtjen dhe shpëtimin” janë marrë gjithashtu në konsideratë.

Gjithashtu, projektligji është hartuar me konsulencën e Departamentit të Mbrojtjes Civile italiane.

Nëpërmjet projektligjit synohet të realizohet modernizimi i sistemit të mbrojtjes civile, i cili do të duhet të jetë në gjendje të përmbushë të gjitha sfidat me të cilat Shqipëria përballet, si një anëtar i NATO-s dhe organizmave të tjerë ndërkombëtarë dhe një aspirant për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Modernizimi i synuar i sistemit të mbrojtjes civile do të kishte si arritje të tij të parë madhore anëtarësimin e shpejtë në mekanizmin e mbrojtjes civile evropiane.

Në bazë të këtij projektligji, zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe modernizmi i sistemit të mbrojtjes civile synohen të arrihet nëpërmjet:

- përmbushjes të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga platformat globale, strategjitë, konventat, iniciativat, marrëveshjet dhe dokumente të tjera të rëndësishme ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes civile, zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë, përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike etj.;
- parashikimit për herë të parë të të gjitha detyrave dhe përgjegjësi të institucioneve, pjesë të sistemit të mbrojtjes civile, subjekteve private, organizatave dhe shoqatave të shoqërisë civile, të shtetasve në tërësi dhe të detyrimeve specifike që lidhen me zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, referuar kuadrit “Sendai” për reduktimin e riskut nga fatkeqësitë 2015-2030;
- forcimit të kapaciteteve administrative, teknike dhe financiare të sistemit të mbrojtjes civile, e cila është tashmë një kërkesë urgjente dhe kritike e kohës;
- krijimit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, e cila, krahasuar me organizimin aktual të Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, do të ketë kapacitete më të mëdha administrative, teknike dhe financiare, sikurse përgjegjësi dhe kompetenca më të gjera, duke u transformuar në këtë mënyrë në një organizatë lider, të denjë dhe të krahasueshme edhe me të gjitha strukturat homologe në rajon dhe në Evropë;
- parashikimit të sanksioneve të qarta për të gjitha institucionet publike, subjektet private, si dhe funksionimit të mekanizmit të inspektimit që do të luajë një rol të rëndësishëm për kontrollin e detyrave dhe përgjegjësi të të gjithë aktorëve të sistemit të mbrojtjes civile;
- rritjes dhe forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar, me qëllim rritjen e shpejtësisë dhe fleksibilitetit në kërkesën, marrjen, pranimin, dhënien dhe kalimin e kufirit shtetëror të asistencës ndërkombëtare. Një theks i veçantë i është dhënë në projektligj ofrimit të asistencës të shtetave të tjera, duke futur përcaktimet e moduleve kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat do të duhet të regjistrohen në kapacitetin e mbrojtjes civile evropiane (*European Civil Protection Pool*) dhe të jenë në gjendje të bashkëveprojnë me kapacitetet e vendeve të tjera gjatë operacioneve të asistencës në vendet e tjera;
- rritjes së efikasitetit, sikurse nivelit të bashkëpunimit të AKMC-së me të gjitha institucionet dhe strukturat në nivel qendror e vendor, shtetasit, subjektet private, organizatat dhe shoqatat e shoqërisë civile, institucionet kërkimore-shkencore, universitetet, organizatat vullnetare, organizmat ndërkombëtare dhe organizatat homologe për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile në të gjithë vendin, nëpërmjet përcaktimit në ligj të të drejtave dhe detyrave të qarta për secilin prej tyre;
- rritjes së rolit të prefektit të qarkut dhe njësive të vetëqeverisjes vendore në zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile;
- sanksionimi i parimit të subsidiaritetit, duke theksuar në këtë mënyrë rolin parësor dhe shumë të rëndësishëm të bashkive në zvogëlimin e riskut të fatkeqësive dhe mbrojtjen civile, që shoqërohet edhe me vendosjen e një kufiri minimal buxhetor të detyrueshëm për këtë qëllim etj. Zbatimi i këtij parimi është i domosdoshëm sikurse nuk e ngadalëson aspak marrjen e masave të duhura po edhe në mënyrë graduale për menaxhimin e fatkeqësive;
- përmirësimit thelbësor të edukimit dhe trajnimit;

- rritjes së rolit të paralajmërimit të hershëm, monitorimit, njoftimit, alarmit, krijimit dhe të ruajtjes së bazës të të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë në menaxhimin e fatkeqësive;
- planifikimit të fondeve financiare për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile nga ana e ministrive dhe bashkive.

Gjatë këtyre viteve ka pasur një nevojë gjithnjë e në rritje për një shtim të kapaciteteve administrative, teknike dhe financiare të DPEC-së. Por ndryshimet e mëdha të ndodhura në këto vite në të gjithë sektorët, nevoja e ngritjes së një sistemi funksional dhe të integruar për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile dhe nevoja për anëtarësimin sa më të shpejtë në mekanizmin e mbrojtjes civile të Bashkimit Evropian kanë bërë imediate një rritje të kapaciteteve të DPEC-së, me qëllim përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësisë të saj, në kontekstin e ri të krijuar.

Sipas këtij projektligji, AKMC-ja do të jetë personi juridik qendror, në varësi të ministrit përgjegjës për mbrojtjen civile.

Përveç sa më sipër, domosdoshmëria e këtij projektligji dhe veçanërisht e krijimit të AKMC-së mbështetet edhe në argumentet, si më poshtë vijon:

1. Sipas raportit të riskut botëror 2016, të botuar nga Universiteti i Kombeve të Bashkuara-Instituti për Mjedisin dhe Sigurinë Njerëzore, që ka përlllogaritur indeksin e riskut nga fatkeqësitë natyrore për vitin 2016 në 171 vende të botës, bazuar në ekspozimin, prekshmërinë dhe kapacitetet përballuese dhe atyre përshtatëse, Shqipëria renditet në vendin e parë në Evropë dhe në vendin e 40-të në botë, gjë që vjen si pasojë e rritjes vit pas viti të prekshmërisë së saj nga fatkeqësitë natyrore, rritjes së ndjeshmërisë ndaj tyre, pamjaftueshmërisë së kapaciteteve përballuese dhe atyre përshtatëse.
2. Sipas Bankës Botërore, Shqipëria ka humbje mesatare vjetore nga tërmetet që vlerësohet të jetë 6.23% të PPB-së dhe humbje mesatare vjetore nga përmbytjet 1.56% e PBB-së.
3. Sipas Bankës Botërore, humbjet nga një tërmet i madh me periudhë rikthimi 250-vjeçare do të ishin 60% e PBB-së, ndërsa nga një tërmet me periudhë rikthimi 100-vjeçare 30% e PBB-së.
4. Në periudhën që nga miratimi i ligjit nr.8756, datë 26.3.2001, “Për emergjencat civile”, të ndryshuar, kanë ndodhur ndryshime dhe zhvillime të shumta, si në fushën e emergjencave ashtu edhe në sektorë të tjerë me ndikim në të, në nivel kombëtar, ashtu edhe në atë ndërkombëtar.
5. Nevojitet përmirësimi i kuadrit ligjor ekzistues të emergjencave civile dhe i dokumenteve themelore, si: Plani Kombëtar për Emergjencat Civile i vitit 2004, dokumenti “Vlerësimi i risqeve nga fatkeqësitë” i vitit 2003.

6. Miratimi i këtij projektligji është dhe detyrim që rrjedh nga Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, miratuar me vendimin nr.348, datë 11.5.2015, të Këshillit të Ministrave, kapitulli 8.5. “Forcimi i rendit publik dhe përgatitjes për rastet e emergjencave civile”.
7. Konkluzionet e raportit të hartuar nga Bashkimi Evropian, Banka Botërore dhe Organizata e Kombeve të Bashkuara pas përmbytjeve të fillimit të shkurtit 2015, në jug të vendit, “Vlerësimi i nevojave pas fatkeqësisë/*Post Disaster Risk Assessment*”. Nga ky raport citojmë, si më poshtë vijon:

“Për të qenë në gjendje që të organizojë zvogëlimin e riskut të fatkeqësive dhe menaxhimin e tyre në një mënyrë efektive, qeveria duhet të disponojë një sistem, i cili të mund të koordinojë aktivitetet për parandalimin dhe përgatitjen ndaj fatkeqësive dhe ku të rregullohet e drejta për të marrë masat e nevojshme në fazat e paralajmërimit të hershëm dhe përgjigjes ndaj një përmbytjeje. Në sistemin e tanishëm, e drejta, kapaciteti dhe financimi i organizatave përkatëse është i kufizuar (faqe 74).

Gjatë përgjigjes nevojitet e drejta për autoritetin e mbrojtjes civile në të tria nivelet e qeverisjes për të ndërmarrë veprim. Autoritetet e mbrojtjes civile në të tria nivelet e qeverisjes duhet të jenë në gjendje që pa marrë leje apo buxhet, të ndërmarrin veprime gjatë një situatë krize. Nevojitet një autorizim që të përshkruajë fuqitë e tyre brenda qeverisjes. (faqe 75).”.

Raporti i mësipërm rekomandon ndërmarrjen e masave të ndryshme që lidhen me legjislacionin, koordinimin ndër-institucional edhe pa shpallje të gjendjes së fatkeqësisë natyrore, planifikimin e fondeve të nevojshme, mësimet e nxjerra pas fatkeqësive, inspektimin, ndërgjegjësimin e komunitetit, evidentimin e kapaciteteve ekzistuese të përgjigjes dhe zhvillimin e kapaciteteve shtesë që nevojiten, marrjen parasysh të projekteve IPA, që zhvillojnë kapacitetet, marrjen parasysh të kapaciteteve ekzistuese rajonale, përdorimin e mënyrave me kosto më efektive për zhvillimin e kapaciteteve, sigurimin e garancisë së vlefshmërisë së kapaciteteve ekzistuese, trajnimin dhe pajisjen e kapaciteteve ekzistuese brenda forcave zjarrfikëse dhe Forcave të Armatosura, përdorimin e organizatave vullnetare dhe Kryqit të Kuq, duke i financuar ato etj.

8. Raporti i progresit i Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2016 shprehet, si më poshtë:

“Nuk ka strategji të mbrojtjes civile dhe ekziston një kapacitet i kufizuar administrativ. Shqipëria po zbaton gradualisht sistemin e saj të komunikimit emergjent në përputhje me numrin e vetëm evropian të emergjencës 112 por ende nuk është i lidhur me sistemin e përbashkët emergjent të komunikimit dhe informimit të BE-së.”.

9. Detyrime të tjera ndërkombëtare, si më poshtë vijon:

- a) Kuadri Sendai për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë 2015-2030, miratuar në konferencën e 3-të Botërore të OKB-së për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë në 18.3.2015 në Japoni, si dhe miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në 3.6.2015.
- b) Plani i Veprimit i Komisionit Evropian mbi implementimin e Sendai-it, si dhe plani i veprimit i OKB-së për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive për Aftësinë Ripërtëritëse.
- c) Detyrimet ndërsektoriale që burojnë nga agjenda për zhvillim të qëndrueshëm 2030, marrëveshja e Parisit mbi ndryshimin e klimës dhe agjenda e re urbane.
- ç) Raporti i Komandës Amerikane në Evropë/EU US Command, korrik 2014:

- “Elementi më kritik i përmirësimit të kapacitetit të gatishmërisë/përgjigjes së organizatës së emergjencave civile në Shqipëri është një organizatë efektive e emergjencave civile. DPEC-ja ka burime të pamjaftueshme dhe autoritet të kufizuar, të cilat pengojnë aftësinë e saj për të udhëhequr përpjekjet e gatishmërisë dhe reagimit ndaj fatkeqësive të qeverisë së Shqipërisë”; (faqe 8).
- Rekomandimet e detajuara për të rritur DPEC-në në nivelin e Agjencisë Kombëtare të Emergjencave Civile janë në çështjen 1; (faqe 16)
- Nuk ekziston një organ ndërinstitucional i nivelit të punës që koordinon aktivitetet e lidhura me fatkeqësitë. Organizata më e përshtatshme për të siguruar këtë koordinim gjithëpërfshirës është DPEC-ja, aktualisht e organizuar nën Ministrinë e Brendshme. Sidoqoftë, DPEC-ja ka personel, financim ose autoritet të pamjaftueshëm për të funksionuar në mënyrë efektive; (faqe 17)
- Kalimi i DPEC-në në një Agjenci Kombëtare të Emergjencave Civile që vepron nën Kryeministrin ose Këshillin e Ministrave dhe identifikimin e kërkesave të fuqisë punëtore. (faqe 18).”.

10. Konkluzionet e vlerësimit të ekipit të mbrojtjes civile të Bashkimit Evropian/UCPM, të hartuar pas përmbytyjeve të shkurtit 2015:

“DPEC ka mungesa stafi dhe kapaciteti për të menaxhuar fatkeqësi natyrore të përmasave të mëdha.”.

Në vijim të sa më lart, miratimi i ligjit “Për mbrojtjen civile” ka dhe një rëndësi strategjike, pasi në nenin 11 të tij “Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë” përcaktohet, si më poshtë vijon:

Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë është dokumenti bazë strategjik i Republikës së Shqipërisë që përcakton politikën dhe aktivitetet

e institucioneve dhe strukturave qendrore dhe vendore, si dhe të gjitha subjekteve të tjera në menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit.”.

Argumentet në favor të pasjes së strategjisë përtej atyre të sipërpërmendura për domosdoshmërinë e ligjit janë, si më poshtë vijon:

1. Hartimi i Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Rrezikut nga Katastrofat është bazuar në ligjin nr.9956, datë 17.7.2008, “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për projektin “Zbutja e riskut nga fatkeqësitë dhe përshtatja”;
2. Miratimi i Strategjisë Kombëtare për Reduktimin e Riskut nga Fatkeqësitë dhe Mbrojtjen Civile është një detyrim ligjor, pasi përbën njërin prej objektiveve të parashikuara në ligjin nr.103/2014, “Për miratimin e strategjisë së siguri kombëtare të Republikës së Shqipërisë”;
3. Përfundimi i strategjisë është me rëndësi të veçantë për Shqipërinë, si një vend shumë i prekshëm nga fatkeqësitë, por dhe me kapacitete të pamjaftueshme njerëzore dhe materiale për përballimin e tyre. Implementimi i strategjisë do t’i shërbejë në radhë të parë garantimit të një zhvillimi të qëndrueshëm të ekonomisë shqiptare, përmirësimit të siguri, por edhe cilësisë së jetës së qytetarëve shqiptarë, sikurse do të ketë një ndikim thelbësor në procesin e përafrimit me *acquis* dhe më gjerë në procesin e përafrimit të vendit tonë me BE-në;
4. Mungesa e strategjisë është në kundërshtim me objektivin e pestë të kuadrit Sendai të reduktimit të riskut të fatkeqësive “Rritja në mënyrë thelbësore e numrit të vendeve me strategji të reduktimit të riskut kombëtar dhe lokal të fatkeqësive deri në vitin 2020”.
5. Mungesa e strategjisë evidentohet si një mangësi në gjetjet e njëpasnjëshme të raporteve të progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë, përfshirë edhe raportin e progresit të fundit për vitin 2018.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS DHE NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në përputhje të plotë me Kushtetutën, në harmoni me legjislacionin vendas, si dhe në linjë me kuadrin “Sendai” për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, më datë 3.6.2015.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS TË BE-SË (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky ligj synon përafrim me acquis të Bashkimit Evropian, si më poshtë:

- Direktivën 2008/114/KE, datë 8.12.2008, “Për identifikimin dhe përcaktimin e infrastrukturave kritike evropiane dhe vlerësimin e nevojës për të përmirësuar mbrojtjen e tyre”. Numri CELEX 32008L0114, “Fletorja zyrtare” e Bashkimit Evropian, seria L, nr.345/75, datë 23.12.2008, faqe 75-83;
- Direktivën 2007/60/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 23.10.2007, “Për vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të përmbytjeve”, Numri CELEX 32007L0060, Fletorja zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, 288/27, datë 6.11.2007, faqe 27-35;
- Direktivën 2012/18/EU, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 4.7.2012, “Mbi kontrollin e rreziqeve të aksidenteve të mëdha që përfshijnë substanca të rrezikshme, duke ndryshuar dhe më pas duke shfuqizuar direktivën e Këshillit 96/82 / EC” (Direktiva Seveso), numri CELEX 32012L0018, “Fletorja zyrtare” e Bashkimit Evropian, seria L, nr.197/1, datë 24.7.2012, faqe 1-38;
- Direktivën 2002/22/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 7.3.2002, “Mbi shërbimin universal dhe të drejtat e përdoruesve në lidhje me rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike (Direktiva e Shërbimit Universal), numri CELEX 32002L0022, “Fletorja zyrtare” e Bashkimit Evropian, seria L, 108, datë 24.4.2002, faqe 51-77;
- Vendimin e Këshillit të datës 23.10.2001, “Krijimi i një mekanizmi të mbrojtjes civile për të lehtësuar bashkëpunimin e përforcuar në ndërhyrjet e asistencës për mbrojtjen civile (2001/792/EC, Euratom)”, numri CELEX 32001D0792, “Fletorja zyrtare” e Bashkimit Evropian, seria L, 297, datë 15.11.2001, faqe 07-11;
- Vendimin (BE) 2019/420 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 13.3.2019 që amendon vendimin nr.1313/2013/BE, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 17.12.2013, “Për mekanizimin e BE-së për mbrojtjen civile”, numri CELEX 32019D0420, “Fletorja zyrtare” e Bashkimit Evropian, seria LI 77/1, datë 20.3.2019, faqe 01-15;
- Vendimin zbatues të Komisionit (BE) 2018/142, të datës 15.1.2018, për ndryshimin e vendimit zbatues 2014/762/BE, i cili përcakton rregullat për zbatimin e vendimit nr.1313/2013 / BE, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për Mekanizmin e Bashkimit të Mbrojtjes Civile (njoftohet nën dokumentin C (2018) 71) (Tekst me rëndësi për ZEE) numri CELEX 32018D0142, “Fletorja zyrtare” e Bashkimit Evropian, seria L 25/40, datë 30.1.2018, faqe 40-48;

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji “Për mbrojtjen civile”, përbëhet nga 13 krerë dhe 75 nene.

Në kreun I të këtij projektligji, me titull “Dispozita të përgjithshme”, është parashikuar qëllimi dhe objekti, misioni i projektligjit, përkufizimet dhe parimet, të cilat udhëheqin veprimtarinë e institucioneve publike qendrore dhe vendore, personave dhe subjekteve private në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera.

Qëllimi i këtij projektligji është zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe realizimi i mbrojtjes civile për të garantuar mbrojtjen e jetës së njerëzve, të pronës, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit, nëpërmjet forcimit të sistemit të mbrojtjes civile dhe rregullimi i funksionimit të sistemit të mbrojtjes civile, duke përcaktuar qartë përgjegjësitë e institucioneve dhe strukturave të këtij sistemi, bashkëpunimin ndërkombëtar, të drejtat dhe detyrimet e shtetasve dhe të subjekteve private, edukimin, trajnimin dhe inspektimin.

Mbrojtja civile synon krijimin e kushteve për një shoqëri të aftë për të përballuar fatkeqësitë e ndryshme dhe për t’u rimëkëmbur, nëpërmjet ngritjes së një sistemi të integruar dhe efikas të mbrojtjes civile në Republikën e Shqipërisë.

Shumica e përkufizimeve të këtij projektligji janë mbështetur në përkufizimet e Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë/UNISDR. Terminologjia është në përputhje të plotë me atë të UNISDR-së, çka e bën ligjin modern dhe në përputhje me terminologjinë bashkëkohore, të përdorur edhe nga organizatat homologe dhe organizmat e tjerë ndërkombëtarë.

Parimet janë përfshirë për herë të parë në ligj dhe ato janë:

- Parimi i së drejtës për mbrojtje;
- Parimi i informimit;
- Parimi i përgjegjësisë;
- Parimi subsidiaritetit.

Në kreun II, me titull “Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë” janë parashikuar dispozitat mbi zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, vlerësimin e riskut, strategjinë kombëtare për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, strategjinë vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, harmonizimin e planeve të zhvillimit urban me strategjitë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, vërtetimin e riskut, si dhe planet për emergjencat civile.

Sipas këtij projektligji, zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë përfshin tërësinë e masave të përcaktuara nga ky ligj, aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, planet, programet dhe dokumentet e tjera.

Vlerësimi i riskut kryhet në nivel qendror, në nivel qarku dhe në nivel vendor, jo më pak se një herë në çdo tre vjet.

- Vlerësimi i riskut në nivel qendror miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.
- Vlerësimi i riskut në nivel qarku miratohet me urdhër të prefektit.
- Vlerësimi i riskut në nivel vendor miratohet me vendim të këshillit bashkiak.

Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë dhe Mbrojtjen Civile do të jetë dokumenti bazë strategjik i Republikës së Shqipërisë, që përcakton politikën dhe aktivitetet e institucioneve dhe të strukturave qendrore e vendore, si dhe të gjitha subjekteve të tjera, në menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit.

Në projektligj është parashikuar se, përpara pajisjes nga organet kompetente me leje zhvillimore, të gjitha subjektet duhet të pajisen me vërtetim mbi riskun.

Planet për emergjencat civile përcaktojnë masat e aktivitetet për parandalimin dhe përballimin e fatkeqësive, sikurse kapacitetet, angazhimin dhe veprimin e organizuar në emergjencë për mbrojtjen e jetës së njerëzve, të pronës, të gjësë së gjallë, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit.

Planet për emergjencat civile miratohen në nivel qendror, në nivel qarku dhe në nivel vendor dhe rishikohen jo më pak se një herë në çdo tre vjet.

Plani Kombëtar për Emergjencat Civile miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

Plani i qarkut për emergjencat civile miratohet me urdhër të prefektit.

Plani vendor për emergjencat civile miratohet me vendim të këshillit bashkiak.

Në kreun III, me titull “Sistemi i mbrojtjes civile”, janë përcaktuar institucionet, strukturat qendrore dhe vendore me role dhe përgjegjësi të veçanta për mbrojtjen civile, duke përfshirë dhe zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë.

Sistemi i mbrojtjes civile përbëhet nga:

- a) institucione dhe struktura qendrore të mbrojtjes civile;
- b) institucione dhe struktura vendore të mbrojtjes civile;
- c) struktura operationale të mbrojtjes civile.

Në këtë kre janë parashikuar e institucionet dhe strukturat qendrore të mbrojtjes civile dhe përgjegjësitë e tyre.

Institucionet dhe strukturat qendrore të mbrojtjes civile përbëhen nga:

- a) Kuvendi;
- b) Këshilli i Ministrave;
- c) Komiteti Ndërminstrior i Emergjencave Civile;
- ç) Komiteti i Mbrojtjes Civile (KMC) dhe Zyra Operacionale e Situatës;
- d) ministri përgjegjës për mbrojtjen civile;
- dh) ministritë dhe institucionet qendrore;
- e) Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile;
- ë) Komisioni teknik këshillimor;
- f) Qendrat e mbrojtjes civile në qark (QMCQ);

Në këtë kre janë përcaktuar roli dhe përgjegjësitë e këtyre institucioneve, në kuadër të forcimit të sistemit të mbrojtjes civile.

Në nenin 22, “Ministritë dhe institucionet qendrore”, është përcaktuar se për ministritë për mbrojtjen civile, mbrojtjen, punët e brendshme, transportin, infrastrukturën, bujqësinë, shëndetësinë, energjetikën, mjedisin dhe kulturën, planifikimi buxhetor duhet të jetë nga 2% deri në 4% e totalit të buxhetit vjetor. Në këtë nen janë përcaktuar dhe më hollësisht detyrat dhe përgjegjësitë e ministrive.

Gjithashtu, është përcaktuar krijimi i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, i cili do të jetë person juridik publik qendror në varësi të ministrit përgjegjës për mbrojtjen civile dhe që do të përgjigjet për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. AKMC-ja do të jetë autoriteti më i lartë koordinues, bashkërendues, drejtues, teknik, mbikëqyrës dhe kontrollues në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile.

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) është person juridik publik qendror, në varësi të ministrit përgjegjës për mbrojtjen civile dhe përgjigjet për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Agjencia ka flamurin, stemën dhe uniformën e saj, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

AKMC-ja ushtron autoritet koordinues, bashkërendues, drejtues, teknik, mbikëqyrës dhe kontrollues në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile.

AKMC-ja organizohet si drejtori e përgjithshme në nivel qendror, ndërsa në nivel vendor organizohet në bazë qarku, sipas qendrave të mbrojtjes civile në qark.

Me përjashtim të drejtorit të Përgjithshëm të AKMC-së, nëpunësit e AKMC-së, në nivel qendror dhe vendor, gëzojnë statusin e nëpunësit civil. Marrëdhëniet e

punës së nëpunësve të AKMC-së, në nivel qendror dhe vendor, rregullohen sipas legjislacionit për statusin e nëpunësit civil. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë të AKMC-së, në nivel qendror dhe vendor, rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.

Organizimi dhe funksionimi i AKMC-së, si dhe detyrat e tjera të saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

Struktura dhe organika e AKMC-së në nivel qendror dhe vendor miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit.

Rregullorja për metodat e brendshme të punës dhe për sjelljen e personelit të AKMC-së në nivel qendror dhe vendor miratohet nga ministri, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të AKMC-së.

Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile është autoriteti më i lartë administrativ i AKMC-së dhe përgjigjet drejtpërdrejt para ministrit për realizimin e politikave dhe të objektivave të përcaktuar. Drejtori i Përgjithshëm i AKMC-së emërohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

Në këtë kre është parashikuar dhe ngritja e qendrave të mbrojtjes civile në qark (QMCQ), të cilat do të jenë institucione në varësi të AKMC-së me seli në çdo qark, të cilat do të zbatojnë detyrat për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile në nivel qarku.

Në kreun III, seksioni 2 janë parashikuar dhe institucionet dhe strukturat vendore të mbrojtjes civile, që përbëhen nga:

- a) prefekti i qarkut;
- b) komisioni i mbrojtjes civile në nivel qarku dhe bashkie;
- c) bashkitë;
- ç) strukturat e decentralizuara të institucioneve dhe të strukturave qendrore të mbrojtjes civile.

Në këtë seksion janë përcaktuar edhe detyrat e këtyre institucioneve dhe strukturave, duke parashikuar në mënyrë të qartë përgjegjësitë e tyre për të gjitha fazat e menaxhimit të fatkeqësive; parandalimin, gatishmërinë, përgjigjen dhe rimëkëmbjen. Një theks i veçantë i është dhënë detyrave në kuadër të zvogëlimin të riskut nga fatkeqësitë. Detyra të veçanta konsistojnë në bashkëpunimin ndërmjet tyre, si dhe bashkëpunimin me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, kryerjen e vlerësimit të riskut të fatkeqësive, hartimin e planeve të emergjencave civile, krijimin e bazës së të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë, sigurimin e funksionimit të sistemit të monitorimit, paralajmërimit të hershëm, njoftimit dhe alarmit, në territorin e tyre etj.

Në nenin “Prefekti i qarkut”, veçojmë detyrën e tij për të kthyer buxhetin e vitit pasardhës të bashkive brenda territorit administrativ të tij, në rast se nuk janë planifikuar të paktën 4% të totalit të buxhetit vjetor, nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit, për marrjen e masave për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile.

Gjithashtu, në këtë kre, ka dhe një nen të dedikuar për strukturat e decentralizuara të institucioneve dhe strukturave qendrore të mbrojtjes civile, të cilat do të angazhohen në mënyrë aktive në zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, si dhe janë pjesë integrale e komisioneve të mbrojtjes civile, në nivel qarku dhe bashkie.

Për sa i përket bashkive veçojmë detyrimin e tyre që për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, si dhe kryerjen e detyrave në zbatim të këtij ligji, mbështeten në parashikimin minimal prej 4 për qind të totalit të buxhetit vjetor të tyre, nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit. Burimet e financimit të tyre janë nga:

- a) të ardhurat e veta vendore;
- b) fondet që u vijnë drejtpërdrejt nga ndarja e taksave e tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacionet;
- c) si dhe nga burime të tjera të parashikuara në ligj.

Nga detyrat e tjera që u janë caktuar bashkive theksojmë hartimin e vlerësimit të risqeve, hartimin dhe rishikimin e Strategjisë për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë dhe planit vendor për emergjencat civile dhe krijimin e bazës së të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë për territorin e bashkisë.

Dhënia e ndihmës financiare për familjet me banesa të dëmtuara nga fatkeqësitë, deri më sot është kryer në përputhje me vendimet e Këshillit të Ministrave, nr.206, datë 26.3.1998, “Për kriteret për pjesëmarrjen e shtetit në përballimin e dëmeve në rast fatkeqësish”, dhe nr.329, datë 16.5.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.

Pavarësisht se në të dyja vendimet e Këshillit të Ministrave parashikohej që nga ana e njësisë të vetëqeverisjes vendore t’u jepej ndihmë financiare familjeve me banesa të dëmtuara nga fatkeqësitë, përvoja e deritanishme ka treguar se fondet e akorduara nga ana e tyre për këtë qëllim kanë qenë të papërfillshme në raport me vlerën që ato duhej të dëmshpërbleheshin dhe, për pasojë, pothuajse të gjitha dosjet dërgoheshin për trajtim pranë pushtetit qendror.

Kështu, për periudhën 2014-2017, përqindja e dëmshpërblimit të akorduar nga bashkitë dhe komunat për familjet me banesa të dëmtuara nga fatkeqësitë e ndryshme është 0.008% e vlerës totale.

Parashikimi ligjor i përmendur, në veçanti për bashkitë që të planifikojnë fondin për ndihmën financiare për familjet me banesa të dëmtuara nga fatkeqësitë është bërë me qëllim që t'i shërbehet më mirë dhe më shpejt qytetarit me banesë të dëmtuar nga fatkeqësia, të shmangen procedurat burokratike dhe abuzimet me tendencë rritjeje të vlerës së preventivit të dëmit të shkaktuar, të menaxhohen më mirë fondet financiare, si dhe të forcohet dhe të rritet roli i njësive të vetëqeverisjes vendore në drejtim të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe të mbrojtjes civile.

Në kreun e tretë, seksioni 3 me titull “Strukturat operacionale të mbrojtjes civile” janë parashikuar si struktura operacionale:

- a) Forcat e Armatosura;
- b) Policia e Shtetit;
- c) Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtim;
- ç) Shërbimi i Urgjencës Mjekësore dhe strukturat e tjera të shërbimit shëndetësor;
- d) shërbimi vullnetar për mbrojtjen civile.

Strukturat operacionale të mbrojtjes civile kryejnë veprimtari që lidhen me planifikimin, kërkim-shpëtimin, dhënien e ndihmës dhe të asistencës në raste fatkeqësish, sigurinë dhe mbrojtjen e zonës së emergjencës civile, rimëkëmbjen e zonave të dëmtuara, si dhe çdo veprimtari tjetër për përballimin e situatës së krijuar.

Gjatë pjesëmarrjes në operacion, efektivat e strukturave operacionale të mbrojtjes civile drejtohen nga eprorët direktë, sipas detyrave që marrin nga drejtuesi i operacioneve.

Në kreun IV, “Gjendja e fatkeqësisë natyrore dhe masat e jashtëzakonshme”, është parashikuar në përputhje me parashikimet kushtetuese, se Këshilli i Ministrave mund të vendosë, për një periudhë jo më të gjatë se 30 (tridhjetë) ditë, gjendjen e fatkeqësisë natyrore në një pjesë ose në të gjithë territorin e vendit, zgjatja e së cilës bëhet vetëm me pëlqimin e Kuvendit.

Kriteret dhe procedurat për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Gjithashtu, janë parashikuar në ligj masat e jashtëzakonshme që mund të vendosen dhe të zbatohen gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore, për përballimin dhe lehtësimin e pasojave të shkaktuara nga fatkeqësitë sipas subjekteve ndaj të cilëve zbatohen, për institucionet publike, strukturat operacionale, subjektet private dhe për shtetasit.

Në këtë kre ka një nen të dedikuar për kompensimin “E drejta e kompensimit”. Sipas këtij neni shteti shqiptar përgjigjet për dëmet që shkaktohen nga pasojat e një fatkeqësie. Dëmet si rregull përballohen nga vetë bashkitë e prekura nga fatkeqësia nëpërmjet fondit të dedikuar për mbrojtjen civile dhe vetëm në rast se vlera e kompensimit tejkalon 8% të buxhetit të bashkisë, KMC-ja mund të vendosë që kompensimi të kryhet nga AKMC-ja.

Së fundmi, sqarojmë se në këtë kre ka dhe një dispozitë të dedikuar që kategorizon llojet e emergjencave civile në emergjenca civile vendore, rajonale dhe kombëtare. Kategorizimi bëhet mbi bazë të intensitetit të shtrirjes së efekteve të fatkeqësisë, me qëllim përcaktimin e llojit të veprimeve dhe të autoritetit përgjegjës për përballimin e saj.

Në kreun V, “Mbrojtja e infrastrukturës kritike dhe trashëgimisë kulturore”, është parashikuar se çfarë përshihet në infrastrukturën kritike dhe infrastrukturën kritike me efekt ndërkuftar, si dhe detyrimi ligjor i institucioneve publike, strukturave qendrore dhe vendore apo dhe subjekteve private, që kanë në administrim apo pronësi infrastrukturë kritike, për të siguruar funksionimin normal të saj, në kushte normale dhe në rastet e fatkeqësive.

Gjithashtu, po në këtë kre është parashikuar detyrimi i institucione publike qendrore dhe vendore, dhe i çdo personi fizik ose juridik, për të mbrojtur nga fatkeqësitë tërësinë e vlerave të trashëgimisë kulturore e historike, që kanë në administrim apo në pronësi.

Në kreun VI, “Paralajmërimi i hershëm, monitorimi, njoftimi dhe alarmi”, janë parashikuar dispozita mbi realizimin e paralajmërimit të hershëm, të monitorimit dhe të njoftimit, nga institucionet dhe strukturat përkatëse, organizimi dhe funksionimi i të cilave rregullohet me akte të ndryshme ligjore dhe nënligjore etj. Këto institucione, në kuadër të mbrojtjes civile, bashkëpunojnë me institucionet dhe strukturat e sistemit të mbrojtjes civile dhe kryejnë detyra specifike.

Gjithashtu, është parashikuar ngritja dhe funksionimi i numrit të unifikuar të emergjencës 112. Ky numër siguron komunikim, paralajmërim të hershëm, njoftim, alarm, informim, koordinim, vendimmarrje, aktivizim dhe ndërhyrje të integruar të strukturave operationale në përballimin e aksidenteve dhe të situatave emergjente që mund të ndodhin në të gjithë vendin.

Numri i unifikuar i thirrjeve emergjente 112 është numër unik emergjence në vendet e BE-së, miratuar si i tillë me vendimin e Këshillit të datës 29 korrik 1991, për futjen e një numri evropian të vetëm thirrjeje për thirrje emergjente (91/396 / EEC).

Numri 112 futet pa pagesë në rrjetet telefonike publike, si dhe në rrjetet digjitale të shërbimeve të integruara të ardhshme dhe shërbimet publike mobile, si numri i vetëm evropian i thirrjeve emergjente

Ngritja dhe funksionimi i sistemit të numrit të unifikuar të thirrjeve emergjente 112 përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Po ashtu, në këtë kre përcaktohet se pranë AKMC-së krijohet dhe funksionon baza e të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë. Institucionet publike dhe private janë të detyruara të bashkëpunojnë me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, dhe t'i japin të dhënat që shërbejnë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile.

Në këtë kre janë parashikuar dispozita për informimin e publikut që përcaktojnë institucionet dhe subjektet e detyruara për njoftim dhe rregullat për paralajmërimin, njoftimin dhe alarmin, sikurse vendosjen në dispozicion për t'u bërë pjesë e sistemit publik të paralajmërimit të hershëm, njoftimit dhe alarmit të Republikës së Shqipërisë, të kapaciteteve të tyre për paralajmërimin e hershëm, njoftimin dhe alarmin e publikut.

Gjithashtu, është parashikuar dhe detyrimi për mediat dhe organet e tjera të informimit publik për t'iu referuar burimeve zyrtare për njoftime sensitive apo të cilat mund të shkaktojnë panik në publik.

Pjesë e këtij kreu janë dhe përcaktimi i dispozitave lidhur me aktivizimin e sinjalit të alarmit, autoritetet përkatëse në nivel qendror dhe vendor, llojet e sinjaleve si dhe detyrimet për funksionimin e mjeteve dhe pajisjeve të paralajmërimit të hershëm, monitorimit, njoftimit dhe alarmit.

Në kreun VII, “Bashkëpunimi ndërkombëtar”, janë përcaktuar rregullat për bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, aktivitetet që përfshijnë bashkëpunimin ndërkombëtar, dispozitat për pranimin dhe dhënien e asistencës ndërkombëtare, parimet ku mbështetet, rregullat mbi kalimin e kufirit shtetëror nga ekipet vendase apo të huaja.

Duke pasur parasysh karakterin proaktiv të sistemit të mbrojtjes civile shqiptare, i cili ka filluar tashmë të manifestohet me dhënien e asistencës ndërkombëtare te shtetet e tjera nga ana e Shqipërisë dhe pritshmëritë e Komisionit Evropian në këtë drejtim, porsa Shqipëria të anëtarësohet në mekanizmin e mbrojtjes civile evropiane, në nenin përkatës janë parashikuar dispozitat përkatëse për këtë qëllim.

Kështu është përfshirë identifikimi apo krijimi i moduleve dhe i kapaciteteve të tjera të përgjigjes emergjente, përmirësimi i ndërveprueshmërisë së tyre, duke marrë parasysh praktikat më të mira në nivelin e shteteve anëtare të BE-së dhe

në nivelin ndërkombëtar për angazhimin e tyre për të përmbushur ndërhyrjen prioritare ose nevojat për mbështetje të shteteve të tjera. Një nen i posaçëm, ai 56 është dedikuar dhënies së asistencës jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në kreun VIII, “Të drejtat dhe detyrimet e shtetasve”, përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e tyre në fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë, sikurse edhe kategoritë e shtetasve që përjashtohen nga detyrimi për angazhim në operacione për parandalimin dhe përballimin e fatkeqësive të ndryshme.

Tek pjesa e detyrimeve mund të veçojmë detyrimin e shtetasve që për qëllime të mbrojtjes civile, me kërkesë të drejtuesve të institucioneve apo strukturave të mbrojtjes civile, të lejojnë kryerjen e punimeve në pasurinë e paluajtshme, si dhe të vendosë në dispozicion mjediset dhe mjetet private. Me kryerjen e punimeve kuptohen punime të ndryshme emergjence që nevojiten të kryhen në pronat private të shtetasve në interes të përballimit të fatkeqësisë në kushtet e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore. Këto mund të jenë punime gjurmimi, elektrike, hidraulike transporti, dezinfektimi etj.

Në kreun e nëntë, me titull “Të drejtat dhe detyrimet e subjekteve private, dhe organizatave jofitimprurëse”, janë përcaktuar të drejtat, si dhe detyrimet e tyre.

Kështu, të gjitha këto subjekte kanë të drejtë të informohen në mënyrë të përhershme dhe të përditësuar për risqet nga fatkeqësitë, si dhe për masat e nevojshme dhe ato të marra për menaxhimin e tyre.

Shoqatat dhe organizatat e shoqërisë civile kanë të drejtë të kryejnë studime për çështje të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë natyrore, të paraqesin konkluzionet përkatëse dhe të jenë partnerë në zbatimin e politikave të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë.

Çdo subjekt privat, vendas apo i huaj, ka të drejtë të kërkojë mbrojtjen e tij dhe të pronës nga strukturat e mbrojtjes civile në rastet e fatkeqësive.

Detyrimet e subjekteve private janë të lidhura me ushtrimin e aktivitetit të tyre dhe të kushteve që duhet të krijojnë për të drejtën e informimit, të mbrojtjes dhe trajnimit të punonjësve, të bashkëpunimit me strukturat e mbrojtjes civile, duke vënë në dispozicion të tyre, automjete, mjete, mjedise private, objekte, pajisje dhe burime energjetike, kundrejt tarifave përkatëse të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, vënies në dispozicion të të dhënave që ata disponojnë dhe që janë të nevojshme për përgatitjen e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë dhe planit të emergjencave civile, si dhe të kompensimit përkatës, i cili përcaktohet rast pas rasti nga Këshilli i Ministrave.

Në veçanti, kur ato përdorin, prodhojnë dhe magazinonë materiale të rrezikshme, karburante dhe derivate të tyre, gaze energjetike, si dhe kryejnë

veprimtari me mjete të rrezikshme, duhet të hartojnë, rishikojnë dhe përditësojnë plane të brendshme për emergjencat civile të harmonizuara me planet e jashtme për emergjencat civile të njësisë apo njërive të vetëqeverisjes vendore, si edhe rregullore të brendshme sipas rrezikshmërisë së proceseve teknologjike.

Ky detyrim është përfshirë në këtë projektligj, në kuadrin e marrjes së masave për ndërgjegjësimin e mbarë shoqërisë shqiptare, në përgjithësi, dhe të subjekteve private në veçanti.

Në kreun X, “Arsimimi dhe trajnimi”, parashikohet arsimimi në nivelin arsimor para universitar mbi mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, në përputhje me profilin e tyre. Ministria përgjegjëse për arsimin, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile siguron përfshirjen në programet mësimore të njohurive për mbrojtjen civile.

Në kreun XI, “Financimi”, është parashikuar mes të tjerave se burimet e financimit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile përbëhen nga:

- a) buxheti i shtetit;
- b) donacione të ndryshme;
- c) burime të tjera që i lejon ligji.

AKMC-ja, nëpërmjet një llogarie në një bankë të nivelit të dytë, krijon një fond solidariteti, për mbrojtjen civile, sipas parashikimeve të këtij ligji. Ky fond përdoret për përballimin e situatave emergjente në përputhje me parashikimet e legjislacionit të prokurimit publik. Fondi i solidaritetit mund t’u transferohet njërive të vetëqeverisjes vendore, me kërkesën e tyre, sipas legjislacionit në fuqi.

Në kreun XII “Inspektimi dhe kundërvajtjet administrative”, parashikohen dispozitat mbi inspektimin për verifikimin e zbatimit të detyrimeve ligjore për mbrojtjen civile që rrjedhin nga ky projektligj, për institucionet dhe strukturat shtetërore dhe për subjektet private.

Inspektimi për zbatimin e dispozitave të këtij ligji, për mbrojtjen civile për institucionet shtetërore dhe subjektet private, kryhet nga inspektorët e AKMC-së, sipas dispozitave ligjore në fuqi për inspektimin.

Shkelja e dispozitave të këtij ligji, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 67, konstatohet nga inspektori i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe mbahet procesverbal i përkatës sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për inspektimin.

Mënyra e konstatimit dhe e shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative, procedurat dhe formati i procesverbalit të konstatimit të shkeljes përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Ekzekutimi i gjobave, në zbatim të këtij ligji, do të kryhet sipas legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.

Në kreun XIII, “Dispozita kalimtare dhe përfundimtare”, janë parashikuar dispozitat deleguese për nxjerrjen e akteve nënligjore, autoritetet përkatëse dhe afati për nxjerrjen e tyre, dispozita e shfuqizimit, dispozita kalimtare e cila parashikon rregullat për periudhën transitore të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Mbrojtjes Civile, të personelit të kësaj drejtorie, si dhe të vazhdimit të fuqisë juridike të akteve nënligjore në fuqi, deri në miratimin e akteve të reja nënligjore, për sa kohë nuk bien në kundërshtim me këtë projektligj.

Ky projektligj parashikohet të hyjë në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QE NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji do të ngarkohet Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, si dhe të gjitha strukturat qendrore, vendore dhe operationale të mbrojtjes civile, sipas përcaktimeve të projektligjit.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe nga përfaqësues të Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, sipas urdhrit të Kryeministrit nr.78, datë 24.5.2018.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk ka efekte financiare të drejtpërdrejta. Në momentin e miratimit të strukturës së re do të përlllogariten dhe efektet financiare.

Efektet financiare do të fillojnë nga data 1 janar 2020.

KËSHILLI I MINISTRAVE